

**POP**

**PERBALLJA  
OFERTAVE  
POLITIKE**

- gendra rinore e vlorës -

**V.Y.C.**

- vlorë youth center -

ZGJEDHJET VENDORE 14 MAJ 2023

KONTRATA SOCIALE



**VLORË**



National Election Commission of Albania



## KONTRATA SOCIALE 2023 – 2027 BASHKIA VLORË

Përballja e Ofertave Politike (POP) është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare, të cilat punojnë në 12 bashki të Shqipërisë. Në bashkinë Vlorë, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga Qendra Rinore e Vlorës (QRV). QRV është një organizatë jo-fitimprurëse që punon në rajonin e Vlorës, prej 1998, në interes të publikut duke respektuar të drejtat e njeriut dhe demokracinë.

Kontrata sociale hartohet nga POP në çdo fushatë elektorale gjatë Zgjedhjeve Lokale në Shqipëri. Hartimi i Kontratës Sociale bazohet në takime me qytetarë të grupeve të ndryshme dhe bazuar në një metodologji për të marrë mendimet dhe prioritetet e tyre.

Në hartimin e kontratës sociale 2023-2027 janë marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e grupeve të ndryshme të qytetarëve brenda territorit të Bashkisë së Vlorës, me një fokus të veçantë për grupet e cenueshme.

Kontrata sociale prezantohet te të gjithë kandidatët për kryetar bashkie gjatë periudhës së fushatës elektorale.

### PRIORITETET KRYESORE

#### Prioriteti 1. Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor

- **Informimi Publik:** Të rritet transparenca për vendimet që merr Këshilli Bashkiak dhe stafi i Bashkisë Vlorë; qytetarët të kenë akses të barabartë në informacion, i cili duhet të jetë miqësor dhe i kuptueshëm përmes e-qeverisjes ose formave të tjera alternative për të arritur te qytetari.
- **Komunikimi Publik:** Përmirësimi i mekanizmave të konsultimit publik duke mos u limituar vetëm në takime publike, por edhe në forma inovative të konsultimit bazuar në legjislacionin lokal, për të rritur ndërveprimin me qytetarët përmes rritjes së kërkesave dhe ankesave që adresohen në kohë, mbledhje prioritetesh online; peticione ose/dhe praktika të referendumeve lokale.
- **Angazhimi dhe Pjesëmarrja Qytetare:** Fuqizimi i mekanizmave lokalë të pjesëmarrjes së qytetarëve (Buxhetimi me Pjesëmarrje) dhe përfaqësimit të të rinjve në Bashkinë Vlorë, përmes Këshillit Vendor të Rinisë dhe Këshillit Vendor të Sigurisë Publike. Alokim fondesh në buxhet për të rinjtë.

## PRIORITETE TË TJERA

### Prioriteti 2. Transport publik cilësor dhe i sigurtë për të gjithë qytetarët e Vlorës

- Afishimi i stacioneve dhe orareve në vendqëndrimet e autobusëve në të gjitha njësitë administrative të Vlorës.
- Në Njësitë Administrative: Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë dhe Shushicë kërkohet që gjatë periudhës së sezonit turistik të jenë funksionale linjat e transportit dhe të zgjaten oraret e lëvizjes së autobusëve.

### Prioriteti 3. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor

- Ngritja e programeve që rrisin angazhimin dhe fuqizojnë ekonomikisht të rinjtë kryesisht në sektorin e turizmit, për të ulur emigrimin dhe për të rritur zhvillimin ekonomik në qytet.
- Krijimi i programeve të veçanta që mbrojnë të rinjtë dhe garantojnë të drejtat për përfshirje sociale.
- Rritja e bashkëpunimit me sektorin e biznesit dhe shoqërisë civile për të vënë në funksion Laboratorin e Turizmit dhe Grupin Lokal të Veprimit Vjona për Njësitë Administrative Qendër dhe Novoselë.

### Prioriteti 4. Shkolla, Kopshte dhe Çerdhe

- Ndërhyrje në infrastrukturën e shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi”, Vlorë.
- Ndërhyrje në infrastrukturën e shkollës 9-vjeçare “Loni Mone” në Fitore (Novoselë)
- Ndërhyrje në infrastrukturën e gjimnazit “Hasan Pulo” në Orikum.

### Prioriteti 5. Garantimi dhe aksesimi në ujë të pijshëm dhe të konsumueshëm.

- Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm në lagjet “Hajro Çakëri”, “Kushtrim” dhe “10 Korriku”.
- Zgjidhja e problemit të mungesës së ujit të pijshëm në lagjen “Lirim”.
- Përfundimi i projektit të furnizimit me ujë të pijshëm të 15 fshatrave të Novoselës.
- Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë në Orikum dhe zgjatja e orarit të furnizimit.
- Zëvendësimi i rrjetit në Qendër dhe përmirësimi i shërbimit të shpërndarjes së ujit të pijshëm në Kaninë, Sherishtë, Zvërnec, Nartë.

### Prioriteti 6. Infrastruktura rrugore

- **Vlorë:** Rikonstruksioni i rrugëve ose i blloqeve të brendshme të banimit, pajisja me ndriçim, trotuare dhe vijëzim i rrugëve në lagjet: “Pavarësia” dhe “Hajro Çakëri”; “Kushtrimi”; Rikonstruksioni i rrugës “Prenjo Petoshati”; lagjet: “24 Maji”; “10 Korriku”, rruga “Daut Metushi”; lagjja “1 Maj”. Ndërhyrje në infrastrukturë në lagjen “28 Nëntori”, (blloku i banimit pas kopshtit nr. 10, deri te rruga “Pilo Begaj”); Rikonstruksioni i rrugës

“Dhimitër Konomi”, ose siç njihet me termin unaza e re, pas dëmtimit nga projekti i ujësjellësit.

- **Novoselë:** Ka nevojë për ndërhyrje në rrugët e brendshme të fshatrave Aliban, Fitore, Delisuf, Poro, Cerkovinë, Trevllazër, Mifol dhe rrugët e varrezave të fshatrave Cerkovinë, Trevllazër, Mifol. Ndriçimi i rrugës Kristo Bena në Skrofotinë.
- **Orikum:** Ndërhyrje në rrugët e brendshme dhe blloqet e banimit në Orikum, rruga buzë detit është bërë vetëm nga njëra anë, duhet bërë ana tjetër deri tek postblloku i vjetër.
- **Njësia Administrative Qendër Vlorë:** Kërkohet ndërhyrje në rrugët e Bestrovës dhe Panajasë dhe në rrugët e brendshme. Kërkohet ndërhyrje në rrugën e Manastirit të Zvernecit (ngritja e një rrethrotullimi dhe hapja e nje vendparkimi për vizitorët)
- **Shushicë:** Rikontruksioni i rrugëve lidhëse Risili-Çepirat-Bunavi.

### Prioriteti 7. Pastrimi dhe Mbetjet Urbane

- Përmirësimi i cilësisë së pastrimit të qytetit dhe njësive administrative sidomos gjatë sezonit turistik.
- Vendosja në funksion e venddepozitimit të mbeturinave në Sherishtë.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;  
Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;  
Qendra Rinore Vlorë,  
Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;  
Epoka e Re, Fier;  
Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;

Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;  
Qendra Rinore për Progres, Kukës,  
Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim,  
Pogradec;  
Gruaja në Zhvillim, Korçë;  
Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;  
Tjetër Vizion, Elbasan